



Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas kërkesës së NP “Termokos”, në bazë të nenit 9 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr. 05/L – 088, nenit 5.2 të Ligjit për Rrugët nr. 2003/11 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 110-391 i miratuar me datën 25.02.2010 në procedurë administrative, Drejtoria merr:

V E N D I M

- I. I Vazhdohet NP “Termokos” që nga data 13.05.2023 deri me datën 14.05.2023, të bëjë bllokimin e përkohshëm të rrugës “Ukshin Hoti” për vendosjen e gypave për realizimin e projektit **zgjerim dhe rehabilitim** të rrjetit të ngrohjes qendrorë në qytetin e Prishtinës nga traseja në këtë segment të rrugëve ashtu siç janë paraparë në bazë të projektit me numër 06-352/07-217330/22, të datës 11.10.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave.
- II. Gjatë realizimit të punimeve operatori ekonomik është i obliguar të ndërmerr të gjitha masat e sigurisë sipas Ligjit për Rrugët nr. 2003/11 nenit 21 dhe 22, udhëzimit administrativë Nr. 09/2017 dhe Ligjit Rregullat e Trafikut Rrugor Nr. 05/L – 088.
- III. Të njoftohet Inspeksioni Komunal, të kërkohet asistenca e Policisë gjatë kohës sa rruga është e bllokuar për orjentimin e pjesëmarrësve në komunikacion gjatë realizimit të punimeve sipas planit të menaxhit të prezentuar në kërkesë si dhe në rast të dëmtimit të segmentit rrugor (Shembjes), parashrusi i kërkesës është i obliguar t’i mar të gjitha masat e sigurisë si dhe ti sanoj dëmet e shkatuar me vete financim.
- IV. Parashtruesi i kërkesës është i obliguar t’i permbahet planit të menaxhimit të trafikut si dhe në rast të ndonjë dëmi të shkaktur duhet ta sanij me mjete vetanake, në të kundërt do të meren masa konform legjislacionit në fuqi.

A r s y e t i m

NP “Termokos”, ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, për tu pajisur me leje për bllokimin e përkohshëm të rrugës “Ukshin Hoti”, për vendosjen e gypave për realizimin e projektit **zgjerim dhe rehabilitim** të rrjetit të ngrohjes qendrorë në qytetin e Prishtinës nga traseja në këtë segment të rrugëve ashtu siç janë paraparë në bazë të projektit me numër 06-352/07-217330/22, të datës 11.10.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave.

Me nenin 11 dhe 12 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr. 05/L – 70 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Prishtinës i miratuar më datën 25.02.2010, është rregulluar me organet kompetente Komunale në përputhje me rregullat e këtij Ligji rregullojnë komunikacionin në kompetencat e tyre, ashtu që për caktojnë sistemin teknik të rregullimit të komunikacionit, hapësirat e parkimit dhe mënyrat e parkimit, kushtet e lëvizjes së automjeteve në zonat e komunikacionit të qetë dhe të këmbësorëve. **Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, _____, të datës 05-05-2023.

Punoi: Magjistër i Komunikacionit
Enver Kadriu

